



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

30.05.2016

Numri i Aktit	Numri i Detyrimit	Shprehja e Aktit	Vlera
01-013/678			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36 paragrafi 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më 24.05.2016, aprovon këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR NJËSINË E ZJARRFIKËSVE

Neni 1.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për njësinë e zjarrfikësve në Komunën e Vitisë.

Neni 2.

Vendi - lokacioni për ndërtimin e objektit për njësinë e zjarrfikësve është në Zonën Kadastrale në Viti, përkatësisht në parcelën kadastrale me numër 2496-5 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2081m² e cila është në pronësi të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Veb faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për kadastrë,
2. Drejtorisë për Shërbime Publike,
3. Shërbimit të Kuvendit dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

